REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 13 nëntor 2026
Nr. ref.:AGJ 3249/26

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI116/25

Parashtrues

Zef Shala

Vlerësim i kushtetutshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës në lëndën [C. nr. 152/12] në Gjykatën Themelore në Pejë, Dega Klinë

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Nexhmi Rexhepi, kryetar
Safet Hoxha, zëvendëskryetar
Bajram Ljatifi, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Zef Shala, me vendbanim në Zvicër (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga Teki Bokshi, avokat nga Gjakova.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës nuk konteston ndonjë akt konkret të autoriteteve publike, por konteston kohëzgjatjen e procedurës përkitazi me gjykimin e lëndës me numër [C. nr. 152/12] në Gjykatën Themelore në Pejë, Dega Klinë (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës përkitazi me gjykimin e lëndës [C. nr. 152/12] në Gjykatën Themelore. Në lidhje me këtë të fundit, parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të paragrafit 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), si dhe paragrafit 1 të nenit 6 (E drejta në proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji). si dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores nr. 01/2023 së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 2 maj 2025, parashtruesi i kërkesës përmes postës elektronike e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 12 maj 2025, Kryetari i Gjykatës përmes Vendimit [Nr. GJR. KI116/25] caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi gjyqtar raportues si dhe përmes Vendimit [Nr. KSH. KI116/25] caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Enver Peci (anëtarë).

7. Më 21 maj 2025, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 20 tetor 2025, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës e njoftoi Gjykatën se Gjykata Themelore ende nuk ka marrë asnjë veprim procedural, si dhe ia bashkëngjiti kopjet e parashtresave "*Urgjenca për caktimin e gjykimit*", të dorëzuara më 5 shtator 2025, 6 tetor 2025 dhe 17 tetor 2025.

9. Më 24 dhjetor 2025, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës e njoftoi Gjykatën sërish se Gjykata Themelore ende nuk ka marrë asnjë veprim procedural, si dhe ia bashkëngjiti kopjen e parashtresës së fundit "*Urgjenca për caktimin e gjykimit*", të dorëzuar më 23 dhjetor 2025.

10. Më 16 shkurt 2026, Gjykata i kërkoi përfaqësuesit të pretenduar të parashtruesit të kërkesës që të dorëzojë: (i) autorizimin specifik; (ii) dëshminë se parashtruesi i kërkesës është palë e paditur në lëndën [C. nr. 152/12]; si dhe (iii) vendimet gjyqësore dhe shkresat relevante që janë proceduar në lidhje me këtë lëndë.

11. Më 18 shkurt 2026, Gjykata pranoi dokumentacionin e kërkuar nga parashtruesi i kërkesës.

12. Më 25 maj 2026, Gjykata i parashtroi pyetje Gjykatës Themelore në Pejë, Dega në Klinë, në mënyrë që të ketë pasqyrë të plotë lidhur me informatat përkitazi me çështjen.

13. Më 9 qershor 2026, Gjykata pranoi nga Gjykata Themelore përgjigjet në pyetjet e parashtruara përkitazi me rastin.

14. Më 14 korrik 2026, Gjykata i parashtroi pyetje shtesë Gjykatës Themelore në Pejë, Dega në Klinë, në mënyrë që të ketë pasqyrë të plotë lidhur me informatat përkitazi me çështjen.

15. Më 24 korrik 2026, Gjykata pranoi nga Gjykata Themelore përgjigjet në pyetjet e parashtruara përkitazi me rastin.

16. Më 30 shtator 2026, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata, njëzëri: (i) deklaroi kërkesën të pranueshme; (ii) konstatoi se ka pasur të paragrafit 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, përkitazi me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm; dhe (iii) urdhëroi Gjykatën Themelore në Pejë, Dega në Klinë, që jo më larg se më 16 maj 2027, të informojë Gjykatën Kushtetuese lidhur me masat e ndërmarra për zbatimin e këtij Aktgjykimi, në pajtim me paragrafin 5 të rregullit 60 (Zbatimi i vendimeve) të Rregullores së punës.

Përmbledhja e fakteve

17. Nga shkresat e lëndës rezulton se më 5 janar 2007, paditësi [N.B.] (në tekstin e mëtejmë: paditësi) parashtroi padi për vërtetim të pronësisë në Gjykatën Komunale në Klinë kundër të paditurve [M.K.], [M.V.], [G.V.] dhe [S.V.].

18. Më 23 qershor 2008, Gjykata Komunale në Klinë, përmes Aktgjykimit [C. nr. 03/07], e aprovoi padinë e paditësit.

19. Në një datë të paspecifikuar, i padituri [M.K.] parashtroi ankesë kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Komunale në Klinë.

20. Më 18 mars 2009, Gjykata e Qarkut në Pejë, përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 531/2008] e ndryshoi Aktgjykimin e lartcekur të Gjykatës Komunale në Klinë, duke e refuzuar padinë e paditësit tërësisht si të pabazuar.

21. Në një datë të paspecifikuar, paditësi parashtroi revizion kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës së Qarkut në Pejë.

22. Më 7 maj 2012, Gjykata Supreme e Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme), përmes Aktgjykimit [Rev. nr. 331/2009], i anuloi aktgjykimet e gjykatave të shkallës më të ulët dhe e ktheu çështjen në rigjykim.

23. Nga shkresat e lëndës rezulton se çështja me shenjën me numër [C. nr. 03/07] u kthye në procedurën e rivendosjes në Gjykatën Themelore në Pejë, Dega në Klinë, ku mori shenjën me numër [C. nr. 152/12].

24. Më 4 shtator 2014, përfaqësuesi i të paditurit [M.K.], gjatë seancës, deklaroi se me vendimin e Gjykatës Supreme është konstatuar se i padituri [S.V.] ka vdekur në vitin 1991 dhe se në këtë situatë nuk ka kushte për procedim të mëtutjeshëm derisa të përcaktohen trashëgimtarët e tij.

25. Në po të njëjtën ditë, përmes aktvendimit procedural, procedura në këtë çështje kontestimore u ndërpre dhe u konstatua se do të vazhdojë *"pas propozimit respktivishtë pas parshtrimit të vendimit për trashëgimtret e të paditurit [S.V.]"*.

26. Më 13 shtator 2016, paditësi paraqiti parashtresë mbi ndryshimin, zgjerimin dhe precizimin e kërkesëpadisë, duke bërë të ditur se tani e tutje baza e kërkesëpadisë së tij është anulimi i kontratës dhe vërtetimi i pronësisë në bazë të mbajtjes.

27. Përmes parashtresës së lartcekur, paditësi e zgjeroi padinë edhe në aspektin subjektiv, ku si të paditur listoi: (i) [S.M.]; (ii) Zef Shala (këtu parashtruesi i kërkesës); (iii) [M.SH.]; (iv) [N.B.]; dhe (v) [U.B.]. Në këtë drejtim, theksohet se: *"Ndaj të paditurës [S.M], Zef Shala dhe [M.SH] zgjerohet padia për faktin se të njëjtit, në mënyrë abuzive, duke i keqpërdorë të drejtat e tyre subjektive, me qellim qe paditësit t'ia pamundësojnë apo vështirësojnë realizimin e kërkesës së tij, e paditura [S.M] e zhvillon procedurën trashëgimtare pas vdekjes se babait të sajë [S.V], shpallët trashëgimtare në 1/3 pjesë ideale të kësaj ngastre, dhe pasi qe regjistrohet si pronare në regjistrimin e të drejtave në patundshmërisë […], në bazë të këtij aktvendimi, ajo se bashku me të paditurit tjerë [M.V] dhe [B.V] përpilon kontratë me shkrim mbi shitblerjen e patundshmërise, me të paditurit Zef Shala dhe [M.SH], tek i njëjti noter, kinse këtë ngastër tani ia shesin Zef [T] Shala, nga Klina, dhe kinso kjo tani si bashkëshorte e tij, e jep pëlqimin qe si blerës të jetë vetëm bashkëshorti i sajë Zef shala, në kuptim të udhëzimit administrativ"*.

28. Më 22 shkurt 2020, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë disiplinore ndaj gjyqtares [X], me arsyetimin se padia është zgjeruar edhe ndaj të paditurve [M.V.] dhe [B.V.], por nuk u është dërguar asnjëherë thirrja e as parashtresa për zgjerim objektiv dhe subjektiv të padisë, edhe pse kanë pasur adresë të tyre në shkresa të lëndës. Njëherësh pretendoi se ishte caktuar masa e përkohshme, ndaj së cilës parashtruesi i kërkesës në afatin ligjor ka paraqitur kundërshtim, andaj më pas gjykata, në bazë të dispozitave ligjore, ka pasur obligim të caktojë seancë në tri (3) ditët e ardhshme. Përkitazi me këtë, parashtruesi i kërkesës në ankesë theksoi se gjyqtari që më parë kishte pasur në punë këtë çështje nuk e kishte caktuar seancën për shkak të shqetësimeve shëndetësore, por gjyqtarja e çështjes, pasi i ishte ndarë kjo lëndë, sipas parashtruesit të kërkesës me dashje nuk kishte caktuar seancë. Po ashtu, në shkresë specifikohet se parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur kundërshtime, urgjenca dhe parashtresa, mirëpo gjyqtarja i kishte injoruar të gjitha kërkesat që gjykata të veprojë.

29. Më 9 mars 2020, U.D Kryetari i Gjykatës Themelore në Pejë, pas vlerësimit të ankesës dhe shikimit të shkresave të lëndës, gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për parashtrimin e kërkesës për fillimin e procedurës disiplinore ndaj ish-gjyqtares [X]. Në kërkesën për fillimin e hetimeve disiplinore theksohet se gjyqtarja e rastit ka injoruar të gjitha kërkesat e parashtruesit të kërkesës për ndërmarrjen e veprimeve, edhe pse seancën për shqyrtimin e kundërshtimit ndaj Aktvendimit për caktimin e masës së përkohshme ka pasur detyrë ta caktojë sipas detyrës zyrtare. Ndër të tjera, specifikohet se *"U.D Kryetari i Gjykatës vlerëson se gjyqtarja ka shkelur obligimin e saj ligjor për kryerjen e detyrës zyrtare me kohë, ashtu siç është paraparë me ligj. Andaj, me këtë rast gjyqtari i çështjes e ka shkelë ligjin e procedurës kontestimore e me këtë edhe ka bërë shkelje disiplinore"*.

30. Më 23 tetor 2020, përfaqësuesi i paditësit kërkoi nga Gjykata që ta ndërpresë procedurën, me arsyetimin se: *"Meqenëse në rastin konkret paditësi nuk gjendet në Kosovë, por punon dhe vepron jashtë territorit te Kosovës, dhe për shkak të mos mundësisë qe te vije në Kosovë, për shkak te pandemisë se Virusit Corona-19, si dhe për shkak qe mua si i autorizuar i tij, me ka humbur kontakti përkohësisht, atëherë në*

kuptim te kësaj dispozite propozojë qe procedure te NDËRPREHET, derisa te plotësohen kushtet për vazhdimin e sajë".

31. Më 11 korrik 2023, paditësi kërkoi që të shtyhet seanca e caktuar më datë 18 korrik 2023, pasi gjendet në pushim vjetor dhe nuk mund të jetë prezent në Kosovë, duke kërkuar që të caktohet seanca në muajin shtator.

32. Më 31 korrik 2023, parashtruesi i kërkesës kërkoi nga kryetari i Gjykatës Themelore në Pejë që ta delegojë lëndën në një gjykatë tjetër, meqë *"çështja është duke u zhvilluar që mbi 16vite dhe ende nuk ka një epilog përfundimtar, përkundër faktit që3 janë mbajtur një numër i madh i shqyrtimeve gjyqësore, dhe në te kanë vepruar disa gjyqtar"*. Tutje, elaboroi se, duke pasur parasysh faktin se të gjitha palët janë nga Klina dhe kanë mundësi ndikimi evident në prolongimin e procedurës, kërkon që kjo çështje të bartet për gjykim në Gjykatën Themelore në Pejë. Sipas parashtruesit të kërkesës: *"Nga analiza e shkresave të lëndës mundësi të përfundoni se ky proces nuk është duke u zhvillua rregullisht. Tash lëndën e ka gjyqtari [Y]. Unë disa herë e kam parë duke qëndruar së bashku gjyqtari [Y] me paditësin, përkatësishtë me vëëain e tij [...]".*

33. Më 8 gusht 2023, paditësi kërkoi që gjyqtari i rastit [Y] të përjashtohet nga gjykimi i rastit.

34. Më 11 gusht 2023, Kryetari i Gjykatës Themelore në Pejë kërkoi që parashtruesi i kërkesës ta plotësojë parashtresën e sipërpërmendur, pasi përmbajtja e kërkesës u konsiderua e paqartë, sepse është kërkuar delegimi i lëndës në një gjykatë tjetër konform nenit 63 (pa titull) të Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejmë: LPK). Po ashtu, theksohet se *"[...] ju sqarojmë se nëse qëllimi juaj është që të parashtroni kërkesë për përjashtim të gjyqtarit [Y], ju duhet të ofroni arsyet mbi të cilat e mbështesni kërkesën tuaj për përjashtimin e tij, të përcaktuara me nenin 67 të LPK-së e po ashtu, duhet të paguani taksën gjyqësore të përcaktuar me [...]. Në anën tjetër, nëse qëllimi juaj është që lënda të delegohet nga Gjykata Themelore në Pejë- Dega në Klinë, në Gjykatën Themelore në Pejë selia, ju duhet të ofroni arsyet mbi të cilat e mbështesni pretendimin tuaj [...]".*

35. Më 16 gusht 2023, kërkesa e paditësit për përjashtim të gjyqtarit [Y] u aprovua dhe lënda u bart te gjyqtari [Z].

36. Më 11 shtator 2023, Gjykata Themelore ne Pejë, Dega në Klinë përmes një njoftimi bëri të ditur se përfaqësuesi i autorizuar i paditësit kishte kërkuar që seanca e caktuar për 29 shtator 2023 të shtyhet për një datë tjetër. Po ashtu, në njoftim theksohet se: *"Andaj,nisur nga kërkesa për shtyrje, e përshkruar si më lartë, por edhe nga arsyet objektive që ka gjykata, që çështjen që iu është caktuar së fundmi, gjyqtari i çështjes, si gjyqtar i ri i ngarkuar me lëndën, vlerëson se i nevojitet një kohë më e gjatë për të lexuar,studiuar çështjen, sepse si e tillë është mjaft voluminoze",* duke bërë të ditur se lidhur me seancën e radhës, gjykata me ftesa të rregullta do t'i njoftojë të gjitha palët ndërgjyqëse.

37. Më 1 mars 2024, procedura në këtë çështje kontestimore u ndërpre për shkak të vdekjes së të paditurit [M.K.]

38. Më 21 maj 2025, përfaqësuesi i të paditurve, kërkoi nga Gjykata Themelore në Pejë, dega në Klinë, që të vazhdohet procedura e ndërprerë, si dhe theksoi se meqë si pasojë e vdekjes së paditurit [M.K.], si bashkëndërgjyqës të domosdoshëm duhet të paraqiten trashëgimtarët, propozon që në anën e të paditurve të shtohen dhe trashëgimtarët e të ndjerit, sikurse në vijim: (i) [M.SH.]; (ii) [K.K.]; (iii) [P.N.]; (iv) [A.K.]; (v) [A.K.]; (vi) [A.K.]; si dhe (vii) [A.K.].

39. Në një datë të paspecifikuar, gjyqtari i rastit [Z] u transferua në Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe lënda në fjalë u bart te gjyqtari [U].

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

40. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e kohëzgjatjes së procedurës përkitazi me gjykimin e lëndës [C. nr. 152/12] në Gjykatën Themelore. Në lidhje me këtë të fundit, ai pretendon shkelje të paragrafit 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta në proces të rregullt) të KEDNJ-së.

41. Në lidhje me legjitimitetin pasiv të tij në lëndën [C.nr. 152/12], parashtruesi në kërkesën e tij thekson se: "*Siç shihet nga padia themelore e njëjta është dorëzuar me dt. 5 janar 2007, fillimisht ka qenë i padituri [M.K.], që është babai i bashkëshortes time [M.SH.], pastaj ndaj meje dhe kundër pronarëve paraprak serb. Meqë shitja është bërë [M.K.] po nuk është arrit që të bartet në emër të babait të bashkëshortes time, për të përmbushur formën kemi arritur marrëveshje, kontratën noteriale LRP 339/2016 Ref.983/2016 d.m.th tokën e kemi blerë së dyti tash Zef Shala dhe [M.SH,] , e lindur [K.]. Mirëpo gjykata si organ shtetëror nuk po vepron që ky kontest të zgjidhet që 19 vite dhe keqtrajtohem nga presioni i jashtëzakonshëm."*

42. Parashtruesi i kërkesës, ndër të tjera, nënvizon se: "*Kontesti ka filluar qe 20 vjet ende nuk ka përfunduar. Në situata të tilla Gjykata Kushtetuese ka praktikë të konsoliduar. Konsideroj se nuk mund të konsiderohet e arsyeshme një periudhë kaq e gjatë kohore për zgjidhjen e një rasti të tillë pranë Gjykatës Themelore Pejë, Dega Klinë, pavarësisht natyrës së rastit. Tejzgjatja e trajtimit të çështjes në fjalë është e papranueshme në rrethanat e rastit konkret dhe si e tillë është në kundërshtim të plotë me të drejtat e mija si palë me kërkesë për gjykim brenda një afati kohor të arsyeshëm, ashtu siç garantohet nga paragrafi 2 të nenit 31 të Kushtetutës dhe paragrafi 1 i nenit 6 të KEDNJ-së.*"

Përgjigjet e Gjykatës Themelore në Pejë, Dega në Klinë, në pyetjet e parashtruara nga Gjykata më 25 maj 2026 dhe 14 korrik 2026

43. Më 25 maj 2026, Gjykata, me qëllim që të ketë një pasqyrë të plotë të rastit, kërkoi nga Gjykata Themelore në Pejë, Dega në Klinë, që të përgjigjet në pyetjet si në vijim:

> *"Kërkohet nga ana Juaj të na ofroni informata rreth historikut, fakteve dhe kronologjisë së trajtimit të këtij rasti që nga parashtrimi i padisë;*
> *Fazën aktuale në të cilën gjendet trajtimi i kësaj çështje juridiko-civile;*
> *Luteni që të informoni Gjykatën përkitazi me arsyet se përse kjo çështje akoma nuk ka përfunduar me shqyrtim meritor të padisë;*
> *Nëse ka pasur pengesa procedurale gjatë trajtimit të lëndës që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e procedurës, luteni të informoni Gjykatën përkitazi me to dhe hapat e ndërmarrë procedural nga ana Juaj për të evituar të njëjtat".*

44. Më 9 qershor 2026, Gjykata pranoi përgjigjet nga Gjykata Themelore në Pejë, Dega në Klinë, e cila theksoi se (i) më 5 janar 2007 është parashtruar padia në Gjykatën Komunale në Klinë; (ii) më 23 qershor 2008 është shpallur aktgjykimi nga Gjykata Komunale në Klinë; (iii) më 28 tetor 2008 është parashtruar ankesë në Gjykatën e Qarkut në Pejë; (iv) më 13 mars 2009, Gjykata e Qarkut në Pejë ka marrë aktgjykim me të cilin ka kërkuar që aktgjykimi i Gjykatës Komunale të ndryshohet; si dhe (v) më 28 maj 2009 është bërë revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës, e cila më 7 maj 2012,

me aktvendim, e ka pranuar revizionin e paditësit dhe e ka kthyer lëndën për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

45. Tutje, Gjykata Themelore në Pejë, Dega në Klinë, specifikoi se pas kthimit të lëndës në rigjykim, e njëjta ka marrë numër të ri [C.nr.152/2012] dhe *" është caktuar te gjyqtarit [V] per vazhdimin e procedurave ku i njejti ka marr vendim për caktim të masës së përkoshëm të sigurisë dhe me pas po i njejti gjyqtar është dal ne pension, ndërsa lënda është bartur tek gjyqtaria [X] e cila i ka vazhduar procedurat dhe ka caktuar nje seance, mirpo me pase është dal ne pension, prap lënda është bartuar te gjyqatri [Y] ne fillim te muajit Shtator 2020 i cili ka vazhduar veprime proceduarale ku ka caktuar seanc me 28.01.2022, ku i njti ka marr vendim me datën 04.03.2022, per heqjen nga fuqia te vendimit të kësaj gjykate për këtë lënde të datës 16.02.2019 me te cilin eshte cekur përfaqësuesi i përkoheshme".*

46. Po ashtu, në përgjigje u theksua se më *pas "me datën 09.12.2022 është mbajtur seanca i cili ka marr vendim qe të aprovohet propozimi i të autorizuarit paditës që ti dërgoj ftesat tre të padituresv ne shtetin e serbis, mirpo më datën 08.08.2023 eshtë bërë kërkesa nga paditësi per përjashtim te gjytarit e cila 16.08.2023 është aprovuar nga kryetari i GJTHP si e bazuar".*

47. Ndërkaq, më pas, bazuar në përgjigjet e dorëzuara në Gjykatë, lënda është bartur te gjyqtari [Z], i cili ka mbajtur seancën përgatitore me datën 15 nëntor 2023, kurse me datën 1 mars 2024 ka marrë vendim për ndërprerjen e procedurës për shkak të vdekjes së njërit të paditur dhe "*më pas gjyqatri është trasferuar ne Gjykaten Themelore ne Prishtine, lënda ne fjale per vazhdimin e proceduarve tjera është bartur tek [U]".*

48. Më 14 korrik 2026, Gjykata i parashtroi pyetje shtesë Gjykatës Themelore në Pejë, Dega në Klinë, në mënyrë që të ketë pasqyrë të plotë lidhur me informatat përkitazi me çështjen sikurse në vijim:

> *"Gjatë kohës sa lënda e apostrofuar më lartë ishte e caktuar për shqyrtim te gjyqtari [V] – (i) sa seanca janë mbajtur; (ii) sa seanca nuk janë mbajtur dhe arsyet se pse nuk janë mbajtur të njëjtat; (iii) cilat janë veprime të tjera procedurale të ndërmarra nga ana e gjyqtarit gjatë kohës sa kishte në shqyrtim rastin; si dhe (iv) periudhën kohore kur gjyqtari [V] është pensionuar?*
> *Gjatë kohës sa lënda e apostrofuar më lartë ishte e caktuar për shqyrtim te gjyqtarja [X]-(i) datën kur gjyqtarja është ngarkuar me lëndën në fjalë; (ii) sa seanca janë mbajtur; (iii) sa seanca nuk janë mbajtur dhe arsyet se pse nuk janë mbajtur të njëjtat; (iv) cilat janë veprime të tjera procedurale të ndërmarra nga ana e gjyqtares gjatë kohës sa kishte në shqyrtim rastin; (v) cili është vendimi i ndërmarrë përkitazi me kërkesën për fillim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtares [X], të inicuar me 9 mars 2020 nga ana e U.D Kryetari i Gjykatës Themelore në Pejë; si dhe (vi) periudhën kohore kur gjyqtarja [X] është pensionuar?*
> *Gjatë kohës sa lënda e apostrofuar më lartë ishte e caktuar për shqyrtim te gjyqtari [Y] -(i) datën kur gjyqtari është ngarkuar me lëndën në fjalë; (ii) sa seanca janë mbajtur; (iii) sa seanca nuk janë mbajtur dhe arsyet se pse nuk janë mbajtur të njëjtat; (iv) cilat janë veprime të tjera procedurale të ndërmarra nga ana e gjyqtarit gjatë kohës sa kishte në shqyrtim rastin; si dhe (v) cila është arsyeja për aprovimin e kërkesës së paditësit për përjashtimin e gjyqtarit [Y]nga trajtimi i lëndës?*
> *Gjatë kohës sa lënda e apostrofuar më lartë ishte e caktuar për shqyrtim te gjyqtari [Z]-(i) datën kur gjyqtari është ngarkuar me lëndën në fjalë; (ii) sa seanca janë mbajtur; (iii) sa seanca nuk janë mbajtur dhe arsyet se pse nuk janë mbajtur të njëjtat; (iv) cilat janë veprime të tjera procedurale të ndërmarra nga ana e*

gjyqtarit gjatë kohës sa kishte në shqyrtim rastin; si dhe (v) cila është data kur gjyqtari është transferuar në Gjykatën Themelore në Prishtinë?
Ndërlidhur me periudhën kohore prejse gjyqtari [U] është ngarkuar me këtë lëndë -(i) datën kur është ngarkuar me lëndën në fjalë; (ii) sa seanca janë mbajtur; si dhe (iii) sa seanca nuk janë mbajtur dhe arsyet se pse nuk janë mbajtur të njëjtat; (iv) cilat janë veprime të tjera procedurale të ndërmarra nga ana e gjyqtarit?"

49. Më 24 korrik 2026, Gjykata pranoi nga Gjykata Themelore përgjigjet në pyetjet e parashtruara përkitazi me rastin, e cila theksoi se në këtë lëndë janë caktuar të mbahen njëzet e shtatë (27) seanca, ku dhjetë (10) janë mbajtur dhe shtatëmbëdhjetë (17) seanca nuk janë mbajtur.

50. Në bazë të përgjigjes së Gjykatës Themelore rezulton se me këtë rast kanë qenë të ngarkuar gjashtë (6) gjyqtarë, të cilët për arsye të ndryshme janë ndërruar, ndërsa tani lëndën e ka gjyqtari i shtatë (7) me radhë.

51. Tutje, në përgjigje specifikohet se në kohën kur gjyqtari [XH] ka qenë i ngarkuar me këtë lëndë janë caktuar tri (3) seanca, më 2 shkurt 2007, 21 dhjetor 2007 dhe 23 qershor 2008, të cilat janë mbajtur. Ndërkaq, kur lëndën e ka pasur në shqyrtim gjyqtari [ZH], është caktuar një (1) seancë, më 2 nëntor 2008, e cila nuk është mbajtur si pasojë e mungesës së adresës së të paditurve.

52. Sipas përgjigjes, në periudhën kur lënda ishte e ngarkuar te gjyqtari [V]: (i) seanca e 4 shtatorit 2014 është mbajtur; (ii) seanca e 12 dhjetorit 2016 nuk është mbajtur, pasi të paditurit nuk janë ftuar në mënyrë të rregullt; (iii) seanca e 7 shkurtit 2017 nuk është mbajtur, pasi është bërë zgjerimi i padisë dhe me kërkesë të palëve është shtyrë; (iv) seanca e 19 korrikut 2017 nuk është mbajtur, pasi ka pasur njoftim nga avokati i parashtruesit të kërkesës për vdekjen e të padituri [M.V]; dhe (v) seanca e *"11 janarit 2019"* nuk është mbajtur, pasi ka pasur parashtresë për shtyrje nga përfaqësuesi i të padituri.

53. Në vijim, në bazë të përgjigjes së Gjykatës Themelore, rezulton se kur lënda ishte e ngarkuar për shqyrtim te gjyqtarja [X]: (i) seanca e 16 majit 2018 nuk është mbajtur dhe është shtyrë me kërkesë të përfaqësuesit të të paditurve; (ii) seanca e 12 qershorit 2018 është mbajtur; (iii) seanca e 12 korrikut 2018 nuk është mbajtur në mungesë të procesmbajtësit, sepse i njëjti ka qenë i vetmi që ka mundur ta mbajë procesverbalin në gjuhën serbe; (iv) seanca e 12 shtatorit 2018 është shtyrë me kërkesë të paditësit; (v) seanca e 25 tetorit 2018 nuk është mbajtur në mungesë të dëshmisë për ftesë të rregullt të palëve në mënyrë të rregullt; (vi) seanca e 13 janarit 2019 është mbajtur; (vii) seanca e 19 gushtit 2019 është mbajtur; (viii) seanca e 25 shtatorit 2019 nuk është mbajtur në mungesë të dëshmisë për ftesë të palëve në mënyrë të rregullt dhe nuk është vendosur në Gazetën Zyrtare për përfaqësuesin e përkohshëm; (ix) seanca e 18 tetorit 2019 nuk është mbajtur në mungesë të përfaqësuesit të përkohshëm dhe të padituri, pasi nuk kanë pranuar ftesë në mënyrë të rregullt; (x) seanca e 15 nëntorit 2019 është mbajtur; (xi) seanca e 16 dhjetorit 2019 është mbajtur; (xii) seanca e 10 shkurtit 2020 është mbajtur; dhe (xiii) seanca e 24 shkurtit 2020 nuk është mbajtur, për shkak të kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit nga përfaqësuesit e të paditurve.

54. Gjatë periudhës kohore kur lënda ishte e caktuar te gjyqtari [Y], Gjykata Themelore theksoi se (i) seanca e 28 janarit 2022 nuk është mbajtur në mungesë të adresës të së paditurve, sepse të njëjtit gjenden në Serbi; (ii) seanca e 8 dhjetorit 2022 nuk është mbajtur, respektivisht është shtyrë me kërkesë të përfaqësuesit të parashtruesit të kërkesës; (iii) seanca e 18 korrikut 2023 nuk është mbajtur pas kërkesës së përfaqësuesit të paditurve avokatit Teki Bokshi dhe avokatit [S.B.] për shtyrje të seancës pas mungesës së palës paditëse [N.B.]; dhe (iv) seanca e 20 shtatorit 2023 nuk është

mbajtur dhe është shtyrë me kërkesën përmes parashtresës së përfaqësuesit të paditësit.

55. Po ashtu, rezulton se seanca e 15 nëntorit 2023, kur gjyqtari i rastit ishte [Z] nuk është mbajtur në mungesë të dëshmisë për ftesë të palëve të paditura në mënyrë të rregullt.

56. Në fund, Gjykata Themelore specifikon se *"Lënda nga data 14.03.2025 i është ndarë gjyqtarit të ri [U], i cili nga kjo datë deri me datë 14.09.2025 ka qenë në periudhë të mentorimit si pjesë e programit në Akademinë e Drejtësisë. Tutje, nga muaji Nëntor 2025 është gjyqtari i vetëm i cili pranon lëndë të rregullta nga lëmia civile përmes sistemit të shpërndarjes së lëndëve në mënyrë elektronike (SMIL), pasi që gjyqtari tjetër është në prag të pensionimit. Si rrjedhojë nga kjo datë e në vazhdim i njëjti është marrë me trajtimin e lëndëve të natyrave urgjente e po ashtu lidhur me objektin e njëjtë të kontestit me palët e njëjta gjyqtari [U] ka zgjidhur lëndën më objekt të kontestit të pengim posedimit dhe si rrjedhojë e kësaj kjo lëndë nuk është caktuar nga gjyqtari aktual"*.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 31
[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. "Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
[...]"

KONVENTA EVROPIANE PER TE DREJTAT E NJERIUT

Neni 6
(E drejta për proces të rregullt)

"1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm [...].
[...]"

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

57. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

58. Në këtë drejtim, Gjykata u referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcakton:

Nenit 113
[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

59. Gjykata gjithashtu u referohet kritereve të pranueshmërisë, siç janë të parashikuara me Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata u referohet neneve 47 (Kërkesa Individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, që parashohin:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

Neni 49
(Afatet)

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor[...]".

60. Sa i përket përmbushjes së këtyre kritereve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar në kuptim të paragrafit 7 të nenit 113 të Kushtetutës dhe se parashtruesi i kërkesës ka saktësuar kërkesën e tij ashtu siç kërkohet me nenin 48 të Ligjit. Në lidhje me afatshmërinë e kërkesës, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës konteston tejzgjatjen e procedurës përkitazi me lëndën [C. nr. 152/12] në Gjykatën Themelore në Pejë, Dega në Klinë. Gjykata, duke pasur parasysh natyrën e pretendimit, gjegjësisht tejzgjatjen e procedurës pranë kësaj instance gjyqësore, rikujton se në rrethana të tilla nuk kërkohet përmbushja e kriterit të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit, përkatësisht kriteri për dorëzimin e kërkesës brenda afatit kohor prej 4 (katër) muajve.

61. Gjykata gjithashtu thekson se kërkesa nuk është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin 2 të rregullit 34 të Rregullores së punës, prandaj ajo duhet deklaruar e pranueshme dhe duhet të shqyrtohen meritat e saj.

Meritat

62. Gjykata rikujton se rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me çështje pronësore, respektivisht një padi për vërtetim të pronësisë që u parashtrua në Gjykatën Komunale në Klinë, më 5 janar 2007. Parashtruesi i kërkesës në këtë çështje kontestimore mori cilësinë e palës së paditur, pasi më 13 shtator 2016, paditësi paraqiti parashtresën mbi

ndryshimin, zgjerimin dhe precizimin e kërkesëpadisë, më anë të së cilës e njoftoi Gjykatën Themelore, se tanimë baza e kërkesëpadisë së tij është anulimi i kontratës dhe vërtetimi i pronësisë në bazë të mbajtjes. Ndërkaq, me po këtë parashtresë e zgjeroi padinë edhe në aspektin subjektiv, ku si palë të paditur listoi edhe parashtruesin e kërkesës, së bashku më katër (4) persona të tjerë. Paraprakisht, para se parashtruesi i kërkesës të merrte cilësinë e palës së paditur, më 23 qershor 2008, Gjykata Komunale në Klinë, përmes Aktgjykimit [C. nr. 03/07] e kishte aprovuar padinë e paditësit, por, më 18 mars 2009, Gjykata e Qarkut në Pejë e ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Klinë, duke e refuzuar padinë tërësisht si të pabazuar. Pas revizionit të paraqitur nga ana e paditësit më 7 maj 2012, Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit [Rev. nr. 331/2009] e ktheu çështjen në rigjykim. Pasi lënda u kthye në rigjykim në Gjykatën Themelore dhe mori numrin [C. nr. 152/12], më 4 shtator 2014, pas propozimit të përfaqësuesit të të paditurit [M.K], pasi deklaroi se është konstatuar se i padituri [S.V] ka vdekur në vitin 1991 dhe se në këtë situatë nuk ka kushte për procedim të mëtutjeshëm derisa të përcaktohen trashëgimtarët e tij, Gjykata Themelore përmes aktvendimit procedural, e ndërpreu procedurën dhe konstatoi se do të vazhdojë *"pas propozimit respktivishtë pas parshtrimit të vendimit për trashëgimtret e të padituri [S.V.]"*. Më 1 mars 2024, procedura në këtë çështje kontestimore u ndërpre për shkak të vdekjes së padituri [M.K]. Ndërsa, më 21 maj 2025, përfaqësuesi i të paditurve kërkoi nga Gjykata Themelore, që të vazhdohet procedura e ndërprerë, si dhe theksoi se, meqë si pasojë e vdekjes së padituri [M.K], si bashkëndërgjyqës të domosdoshëm duhet të paraqiten trashëgimtarët, propozon se në anën e të paditurve të shtohen edhe trashëgimtarët e të ndjerit, sikurse në vijim: (i) [M.SH]; (ii) [K.K]; (iii) [P.N]; (iv) [A.K]; (v) [A.K]; (vi) [A.K]; si dhe (vii) [A.K]. Kjo lëndë nga rikthimi në rigjykim e deri në momentin e parashtrimit në Gjykatë të kërkesës për vlerësim të kohëzgjatjes së procedurës nuk ka përfunduar me ndonjë vendim meritor.

63. Në kërkesën e tij para Gjykatës, parashtruesi i kërkesës specifikon se i është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si rezultat i kohëzgjatjes së procedurës përkitazi me procedurën në lëndën [C. nr. 152/12].

64. Gjykata në vijim do të shqyrtojë pretendimin e parashtruesit të kërkesës për tejzgjatje të procedurës së zhvilluar dhe do ta trajtojë nga këndvështrimi i të drejtave të garantuara përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, duke aplikuar edhe parimet dhe kriteret e vendosura përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

I. Parimet e përgjithshme lidhur me kohëzgjatjen e procedurës gjyqësore

65. Gjykata rikujton se është detyrim i shtetit që të organizojë sistemin e drejtësisë në mënyrë të tillë që gjykatat të mund të garantojnë të drejtat e secilit për një vendim përfundimtar gjyqësor, në lidhje me të drejtat dhe obligimet civile të tyre brenda një afati të arsyeshëm kohor (shih rastin e Gjykatës: KI129/25, parashtrues *Adem Dervishaj,* Aktgjykim i 1 tetorit 2025; si dhe rastet e GJEDNJ-së: *Comingersoll kundër Portugalisë*, nr. 35382/97, Aktgjykim i 6 prillit 2000, paragrafi 24; *Famullia Katolike Greke e Lupenit dhe të tjerët kundër Rumanisë*, nr. 76943/11, Aktgjykim i 29 nëntorit 2016, paragrafi 142). Arsyeshmëria e zgjatjes së një procesi gjyqësor duhet të vlerësohet duke u bazuar në rrethanat përkatëse të secilit rast (shih rastin e GJEDNJ-së: *Frydlender kundër Francës*, nr. 30979/96, Aktgjykim i 27 qershorit 2000, paragrafi 43). Arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurës gjyqësore matet duke u bazuar në këto kritere kryesore: kompleksiteti i rastit, sjellja e palës, sjellja e autoriteteve shtetërore dhe rëndësia e asaj se çfarë është në rrezik për palën në kontestin gjyqësor (shih rastet

e GJEDNJ-së: *Sürmeli kundër Gjermanisë*, nr. 75529/01, Aktgjykim i 8 qershorit 2006, paragrafi 128; dhe *Nicolae Virgiliu Tanase kundër Rumanisë*, nr. 41720/13, Aktgjykim i 25 qershorit 2019, paragrafi 209).

66. Gjykata, për të ardhur në përfundim nëse në rastin e parashtruesit të kërkesës, rasti i tij ishte trajtuar brenda afatit të arsyeshëm, në vijim do të vlerësojë: (i) ndërlikueshmërinë e rastit, (ii) sjelljen e palës, (iii) sjelljen e autoriteteve shtetërore, si dhe (iv) rëndësinë e asaj se çfarë është në rrezik për palën në kontestin gjyqësor.

a) ndërlikueshmëria e rastit

67. Sipas praktikës së GJEDNJ-së, ndërlikueshmëria e rastit mund të ndërlidhet me çështjet faktike dhe ligjore; me përfshirjen e disa palëve në procedurë; me një numër të caktuar provash që duhet trajtuar para gjykatave të rregullta; apo edhe me një numër më të madh të raporteve të ekspertëve që kërkohen (shih, në mënyrë të ngjashme, rastet e Gjykatës: KI64/23, cituar më lart, paragrafët 66-67 dhe KI142/23, parashtrues *Fadil Berisha*, Aktgjykim i 12 shkurtit 2025, paragrafi 49; si dhe rastet e GJEDNJ-së: *Papachelas kundër Greqisë*, nr. 31423/96, Aktgjykim i 25 marsit 1999; *Humen kundër Polonisë*, nr. 26614/95, Aktgjykim i 15 tetorit 1999, paragrafi 63; dhe *Nicolae Virgiliu Tanase kundër Rumanisë*, nr. 41720/13, Aktgjykim i 25 qershorit 2019, paragrafi 210).

68. Edhe në rastet kur një procedurë nuk është komplekse, mungesa e qartësisë dhe parashikueshmërisë në legjislacionin vendor, mund të vështirësojë zgjidhjen e rastit dhe të kontribuojë në kohëzgjatjen e procedurës (shih rastin e GJEDNJ-së: *Famullia Katolike Greke e Lupenit dhe të tjerët kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 150).

b) sjellja e palës

69. Sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, të afirmuar edhe nga vetë Gjykata, neni 6 i KEDNJ-së, respektivisht neni 31 i Kushtetutës, nuk kërkon nga pala bashkëpunim aktiv me autoritetet gjyqësore, e as nuk mund të fajësohet për përdorimin e mjeteve juridike sipas legjislacionit në fuqi. Megjithatë, autoritetet shtetërore nuk mund të mbahen përgjegjëse nëse këto veprime ndikojnë në kohëzgjatjen e procedurës (shih rastin e Gjykatës: KI142/23, parashtrues *Fadil Berisha*, cituar më lart, paragrafi 50; si dhe rastet e GJEDNJ-së: *Erkner dhe Hofauer kundër Austrisë*, nr. 9616/81, Aktgjykim i 23 prillit 1987, paragrafi 68; dhe *Nicolae Virgiliu Tanase kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 211). Vetëm vonesat që i atribuohen shtetit mund të ndikojnë në përcaktimin nëse procedurat nuk kishin përfunduar brenda një afati të arsyeshëm kohor (shih rastin e GJEDNJ-së: *Humen kundër Polonisë*, cituar më lart, paragrafi 66).

70. Disa shembuj që kanë të bëjnë me sjelljen e palës: (i) mungesa e vullnetit të palës për të dorëzuar shkresat mund të ndikojë në ngadalësimin e procedurës; (ii) ndryshimi i shpeshtë i avokatit; përpjekjet për të arritur marrëveshje jashtëgjyqësore; (iii) nisja e procedurës para gjykatës që nuk ka juridiksion për çështjen; (iv) mungesa e kujdesit në ndërmarrjen e hapave proceduralë (shih rastin e Gjykatës: KI33/25, parashtruese *Dobrila Rakić,* Aktvendim për papranueshmëri i 4 shtatorit 2025, paragrafi 68 si dhe rastet e GJEDNJ-së: *Beaumartin kundër Francës*, nr. 15287/89, Aktgjykim i 24 nëntorit 1994, paragrafi 33; dhe *Keaney kundër Irlandës*, nr. 72060/17, Aktgjykim i 30 prillit 2020, paragrafi 95).

c) sjellja e autoriteteve shtetërore

71. Shteti mban përgjegjësi për të gjitha autoritetet, jo vetëm për sistemin gjyqësor, por për të gjitha institucionet publike (shih rastin e GJEDNJ-së: *Martins Moreira kundër Portugalisë*, cituar më lart, paragrafi 60). Gjatë vlerësimit nëse procedura është kryer

brenda një afati të arsyeshëm kohor, Gjykata duhet ta vlerësojë procedurën në tërësi: përkundër që shteti mund të jetë përgjegjës për defekte të caktuara procedurale, megjithatë kjo nuk e përjashton mundësinë që të ketë vepruar në përputhje me detyrat e veta për ta shqyrtuar rastin në mënyrë të shpejtë (shih rastin e Gjykatës: KI64/23, parashtruese *Mejrem Qehaja Rexha*, Aktgjykim i 31 gushtit 2023, paragrafët 71-73; si dhe rastin e GJEDNJ-së *Nicolae Virgiliu Tanase kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 211).

72. Shkaktimi i vonesave nga ndërrimi i shpeshtë i gjyqtarëve nuk e shmang përgjegjësinë e shtetit për kryerjen e procedurave brenda afateve të arsyeshme kohore, sepse është detyrë e shtetit që të organizojë sistemin e drejtësisë në mënyrë të përshtatshme (shih rastin e GJEDNJ-së: *Lechner dhe Hess kundër Austrisë*, nr. 9316/81, Aktgjykim i 23 prillit 1987, paragrafi 58). Mbingarkesa kronike e lëndëve nuk mund të shërbejë si arsyetim për tejzgjatjen e procedurave (shih rastin e GJEDNJ-së: *Probstmeier kundër Gjermanisë*, nr. 20950/92, Aktgjykim i 1 korrikut 1997, paragrafi 64). Vonesat e shkaktuara nga reformat që synojnë të përshpejtojnë zgjidhjen e rasteve po ashtu nuk mund të shërbejnë si arsyetim për tejzgjatje të procedurës, për shkak se është përgjegjësi dhe detyrë e shtetit ta organizojë sistemin e drejtësisë në mënyrë që të shmangë tejzgjatjen e procedurave në rastet e mbetura pa u zgjidhur (shih rastin e GJEDNJ-së: *Fisanotti kundër Italisë*, nr. 32305/96, Aktgjykim i 23 prillit 1998, paragrafi 22). Gjykata në praktikën e saj gjyqësore ka theksuar se gjykatat e rregullta duhet të kenë parasysh obligimin kushtetues dhe ligjor që çështjet t'i finalizojnë brenda një afati të arsyeshëm, në mënyrë që vonesat e tejzgjatura të mos shkaktojnë pasiguri te palët. Gjykatat nuk mund të lejojnë që rasti të bartet pafundësisht prej një instance gjyqësore te tjetra. Në të kundërtën, besimi i publikut ndaj rendit juridik do të rrezikohej (shih rastin e Gjykatës: KI06/21, parashtrues *Dragan Mihajlović*, Aktgjykim i 22 dhjetorit 2022, paragrafi 67).

d) rëndësia e asaj se çfarë është në rrezik për palën në procedurë

73. Sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, ekzistojnë kategori të caktuara të rasteve, të cilat, për nga natyra e tyre duhet të trajtohen me kujdes të veçantë dhe të vendosen me shpejtësi më të madhe. Shembuj të këtyre kategorive të rasteve përfshijnë: (i) rastet që ndërlidhen me statusin; (ii) rastet që ndërlidhen me kujdestarinë e fëmijëve; me raportin prind-fëmijë; me kujdesin e gjyshërve ndaj fëmijëve, kur këta të fundit kanë mbetur pa kujdesin e prindërve; përgjegjësinë e prindërve dhe të drejtat e kontaktit me fëmijët; (iii) rastet që ndërlidhen me kontestet nga marrëdhënia e punës; ankesa kundër largimit nga puna; suspendimi nga puna; transferimi; rikthimi në punë; (iv) rastet që ndërlidhen me persona të cilët vuajnë nga "*sëmundje të pashërueshme"* dhe kanë *"pritje të reduktuar të jetëgjatësisë*"; (v) rastet që lidhen me pretendimet për ushtrim të dhunës nga zyrtarët policorë; dhe (vi) rastet kur mund të rrezikohet e drejta e edukimit. Disa raste të tjera nuk kërkojnë vëmendje të shtuar, p.sh. rastet që lidhen me kompensimin e dëmit të shkaktuar në aksidente rrugore, apo rastet që kanë të bëjnë me ndarjen e trashëgimisë ndërmjet trashëgimtarëve të personit të vdekur (shih rastet e Gjykatës: KI64/23, parashtruese *Mejrem Qehaja Rexha,* cituar më lart, paragrafi 74; KI142/23, parashtrues *Fadil Berisha,* cituar më lart, paragrafi 52; dhe KI211/25, parashtruese *Burbuqe Prruthi,* Aktgjykim i 11 dhjetorit 2025, paragrafi 63; dhe rastet e GJEDNJ-së: *Mikulić kundër Kroacisë*, nr. 53176/99, Aktgjykim i 7 shkurtit 2002, paragrafi 44; *Q dhe R kundër Sllovenisë*, nr. 19938/20, Aktgjykim i 8 shkurtit 2022, paragrafi 80; *A dhe të tjerët kundër Danimarkës*, nr. 20826/92, Aktgjykim i 8 shkurtit 1996, paragrafët 78-81).

II. Aplikimi i parimeve në rrethanat e rastit konkret

Periudha që do të merret parasysh

74. Gjykata rikujton se padia në këtë rast është paraqitur më 5 janar 2007, dhe e njëjta vazhdoi të shqyrtohej edhe pas 15 qershorit 2008, kur hyri në fuqi Kushtetuta dhe deri më 2 maj 2025 që korrespondon të jetë data e parashtrimit të kërkesës në Gjykatë për vlerësim të kushtetutshmërisë së tejzgjatjes së procedurës kanë kaluar gjashtëmbëdhjetë (16) vite, dhjetë (10) muaj dhe shtatëmbëdhjetë (17) ditë ndërlidhur me çështjen juridiko-civile që ende pret të zgjidhet në merita nga Gjykata Themelore. Gjykata po ashtu vëren se më 13 shtator 2016, parashtruesi i kërkesës mori cilësi të palës në këtë procedurë kontestimore, respektivisht subjektit të paditur me rastin e paraqitjes nga ana e paditësit të parashtresës mbi ndryshimin, zgjerimin dhe precizimin e kërkesëpadisë, më anë të së cilës e njoftoi Gjykatën Themelore se baza e kërkesëpadisë së tij është anulimi i kontratës dhe vërtetimi i pronësisë në bazë të mbajtjes. Ndërkaq, me po këtë parashtresë e zgjeroi padinë edhe në aspektin subjektiv, ku si palë të paditur listoi edhe parashtruesin e kërkesës. Përkitazi me kohëzgjatjen e procedurës nga përfshirja e parashtruesit të kërkesës në cilësinë e palës ndërgjyqëse në këtë kontest civil, Gjykata vëren se nga 13 shtator 2016 deri më 2 maj 2025, kanë kaluar tetë (8) vjet, shtatë (7) muaj dhe nëntëmbëdhjetë (19) ditë dhe se kjo është periudha që duhet marrë parasysh në lidhje me pretendimet e parashtruesit të kërkesës.

75. Për të arritur një përfundim se a është zgjidhur rasti i parashtruesit të kërkesës brenda një afati të arsyeshëm, Gjykata më tej do të vlerësojë: (a) ndërlikueshmërinë e rastit, (b) sjelljen e palës, (c) sjelljen e organeve shtetërore, si dhe (d) rëndësinë e asaj që është në rrezik për palën në kontestin gjyqësor.

(a) Përkitazi me ndërlikueshmërinë e rastit

76. Gjykata vëren se rasti i parashtruesit të kërkesës, në të cilin ka cilësinë e palës së paditur, ka të bëjë me çështje pronësore, respektivisht me anulimin e kontratës dhe vërtetimin e pronësisë në bazë të mbajtjes. Gjykata vëren se në këtë rast ka të përfshirë shumë palë në cilësinë e të paditurve, dhe se natyra e rastit është komplekse dhe mund të kërkojë shqyrtimin e shumë çështjeve faktike dhe ligjore, përfshirë këtu administrimin dhe vlerësimin e provave, me një nivel të një kompleksiteti të caktuar faktesh apo provash, marrë parasysh edhe faktin e palëve të shumta ndërgjyqëse të përfshira në këtë kontest civil-juridik. Megjithatë, Gjykata vlerëson se, pavarësisht ekzistimit të një niveli të caktuar kompleksiteti nuk mund të justifikohet një procedurë me kohëzgjatje sikurse ajo e përcaktuar më lart. Përkundrazi, sipas parimeve të vendosura në praktikën e GJEDNJ-së edhe kur ekziston një kompleksitet i caktuar i rastit, një kohëzgjatje e tillë e procedurës tejkalon kufijtë e një afati të arsyeshëm dhe tregon mungesë efikasiteti dhe parashikueshmërie ligjore në veprimtarinë e gjykatave.

(b) Sa i përket sjelljes së palës

77. Në lidhje me sjelljen e parashtruesit të kërkesës, Gjykata rikujton se nuk kërkohet nga pala që të bashkëpunojë në mënyrë aktive me organet gjyqësore, as nuk mund të konsiderohet përgjegjëse për përdorimin e mjeteve juridike procedurale të lejuara me ligj. Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës ka vepruar brenda të drejtave të tij ligjore, duke përdorur mekanizmat ligjorë në dispozicion për të mbrojtur interesat e tij, me rastin e parashtrimit të (i) ankesës disiplinore të 22 marsit 2020 ndaj gjyqtares së rastit; dhe më pas (ii) kërkesës e 31 korrikut 2023 për delegimin e lëndës për shqyrtim në një gjykatë tjetër.

78. Gjykata vëren që shtatë (7) seanca nuk janë mbajtur dhe kryesisht ndërlidhen me kërkesa dhe veprime të përfaqësuesit të palëve të paditura, përfshirë këtu parashtruesin e kërkesës, dhe atë për arsyet si në vijim: (i) seanca e 7 shkurtit 2017, me rast të zgjerimit të padisë, ku nga palët në procedurë ishte kërkuar të shtyhet seanca; (ii) seanca e 19

korrikut 2017, nuk ishte mbajtur me rastin e njoftimit të përfaqësuesit të paditurve për vdekjen e të paditurit [M.V]; (iii) seanca e 11 janarit 2019 përmes parashtresës për shtyrje nga përfaqësuesi i të paditurve; (iv) seanca 16 majit 2019 me kërkesë për shtyrje nga përfaqësuesi i të paditurve; (v) seanca e 24 shkurtit 2020 ishte shtyrë për shkak të kërkesës për përjashtimin e gjyqtares [X] nga përfaqësuesit e të paditurve; (vi) seanca e 8 dhjetorit 2020 me kërkesë të përfaqësuesit të paditurve për shtyrje; si dhe (vii) seanca e 18 korrikut 2023 nuk ishte mbajtur pas kërkesës së përfaqësuesit të paditurve për shtyrje të seancës pas mungesës së përfaqësuesit të paditësit.

79. Në anën tjetër, Gjykata vëren se për tri (3) seanca që nuk ishin mbajtur si rrjedhojë e kërkesës së përfaqësuesit të palëve të paditura për shtyrje të seancës, nuk janë dhënë informata nga ana e Gjykatës Themelore mbi arsyet e kërkesave për shtyrje të së njëjtave.

80. Gjykata sjellë në vëmendje më 22 shkurt 2020, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar ankesë disiplinore ndaj gjyqtares [X] me arsyetimin se padia është zgjeruar edhe ndaj të paditurve [M.V.] dhe [B.V.], por nuk u është dërguar asnjëherë thirrja e as parashtresa për zgjerim objektiv dhe subjektiv të padisë, edhe pse kanë pasur adresë të tyre në shkresa të lëndës. Njëherësh pretendoi se ishte caktuar masa e përkohshme, ndaj së cilës parashtruesi i kërkesës në afatin ligjor ka paraqitur kundërshtim, për çka më pas, gjykata në bazë të dispozitave ligjore ka pasur obligim të caktojë seancë në tri (3) ditët e ardhshme. Përkitazi me këtë, parashtruesi i kërkesës në ankesë kishte theksuar se gjyqtari që më parë kishte pasur në shqyrtim këtë çështje, nuk e ka caktuar seancën pasi i njëjti kishte shqetësime shëndetësore, por gjyqtarja e çështjes pasi i ishte ndarë kjo lëndë, sipas parashtruesit të kërkesës me dashje, nuk kishte caktuar seancë. Sipas parashtruesit të kërkesës, ai kishte paraqitur kundërshtime, urgjenca dhe parashtresa, por gjyqtarja i kishte injoruar të gjitha kërkesat që gjykata të veprojë. Më 9 mars 2020, U.D Kryetari i Gjykatës Themelore në Pejë, pas vlerësimit të ankesës dhe shikimit të shkresave të lëndës kishte gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore për parashtrimin e kërkesës për fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtares [X]. Në kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore theksohej se gjyqtarja e rastit ka injoruar të gjitha kërkesat e parashtruesit të kërkesës për ndërmarrjen e veprimeve, edhe pse seancën për shqyrtimin e kundërshtimit ndaj Aktvendimit për caktimin e masës së përkohshme ka pasur detyrë ta caktojë sipas detyrës zyrtare. Ndër të tjera, specifikohej se *"U.D Kryetari i Gjykatës vlerëson se gjyqtarja **ka shkelur obligimin e saj ligjor për kryerjen e detyrës zyrtare me kohë**, ashtu siç është paraparë me ligj. Andaj, me këtë rast gjyqtari i çështjes e ka shkelë ligjin e procedurës kontestimore e me këtë edhe ka bërë shkelje disiplinore"*.

81. Gjykata po ashtu rikujton se më 31 korrik 2023, parashtruesi i kërkesës kërkoi nga kryetari i Gjykatës Themelore në Pejë që ta delegojë lëndën në një gjykatë tjetër, meqë *"çështja është duke u zhvilluar që mbi 16vite dhe ende nuk ka një epilog përfundimtar, përkundër faktit që janë mbajtur një numër i madh i shqyrtimeve gjyqësore, dhe në te kanë vepruar disa gjyqtar"*. Tutje, elaboroi se, duke pasur parasysh faktin se të gjitha palët janë nga Klina dhe kanë mundësi ndikimi evident në prolongimin e procedurës, kërkon që kjo çështje të bartet për gjykim në Gjykatën Themelore në Pejë. Sipas parashtruesit të kërkesës: *"Nga analiza e shkresave të lëndës mundësi të përfundoni se ky proces nuk është duke u zhvillua rregullisht. Tash lëndën e ka gjyqtari [Y]. Unë disa herë e kam parë duke qëndruar së bashku gjyqtari [Y] me paditësin, përkatësishtë me vëëain e tij"*. Ndërkaq, më 11 gusht 2023, Kryetari i Gjykatës Themelore në Pejë kërkoi që parashtruesi i kërkesës ta plotësojë parashtresën e sipërpërmendur, pasi përmbajtja e kërkesës u konsiderua e paqartë, sepse është kërkuar delegimi i lëndës në një gjykatë tjetër konform nenit 63 (pa titull) të Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejmë: LPK). Po ashtu, theksohet se *"[...] ju sqarojmë se nëse qëllimi juaj është që të parashtroni kërkesë për përjashtim të gjyqtarit [Y], ju duhet të ofroni*

arsyet mbi të cilat e mbështesni kërkesën tuaj për përjashtimin e tij, të përcaktuara me nenin 67 të LPK-së e po ashtu, duhet të paguani taksën gjyqësore të përcaktuar me [...]. Në anën tjetër, nëse qëllimi juaj është që lënda të delegohet nga Gjykata Themelore në Pejë- Dega në Klinë, në Gjykatën Themelore në Pejë selia, ju duhet të ofroni arsyet mbi të cilat e mbështesni pretendimin tuaj [...]".

82. Gjithashtu, Gjykata vëren se me rastin e ndërprerjes së çështjes kontestimore më 1 mars 2024, për shkak të vdekjes së padituri [M.K.], përfaqësuesi i palëve të paditura, përfshirë këtu parashtruesin e kërkesës, më 21 maj 2025, kishte ndërmarrë veprime aktive, duke kërkuar nga Gjykata Themelore që të vazhdohet procedura e ndërprerë, si dhe duke informuar se si pasojë e vdekjes së padituri [M.K.], si bashkëndërgjyqës të domosdoshëm duhet të paraqiten trashëgimtarët, duke propozuar që në anën e të paditurve të shtohen edhe trashëgimtarët e të ndjerit sikurse në vijim: (i) [M.SH.]; (ii) [K.K.]; (iii) [P.N.]; (iv) [A.K.]; (v) [A.K.] ; (vi) [A.K.] ; si dhe (vii) [A.K.].

83. Nga ato më sipër, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës pavarësisht se ka ndërmarrë veprime procedurale dhe ka ushtruar të drejtën e tij për mjetet procedurale që i kishte në dispozicionin, përmes tyre, por edhe përmes kërkesave për shtyrje të seancave, i ka kontribuar vonesës së procedurës.

(c) Sjellja e autoriteteve kompetente

84. Në lidhje me sjelljen e autoriteteve kompetente, Gjykata rikujton se shteti është përgjegjës për funksionimin efikas të të gjitha organeve të tij, duke përfshirë edhe sistemin gjyqësor, dhe se mbingarkesa kronike e gjykatave me raste, ndryshimet e shpeshta të gjyqtarëve ose vështirësitë administrative nuk mund të shërbejnë si justifikim për zgjatjen e tepruar të procedurës gjyqësore. Në rastin konkret, Gjykata vëren me këtë çështje civile juridike kishin qenë të ngarkuar gjashtë (6) gjyqtarë, ndërkaq tani lëndën në punë e ka gjyqtari i shtatë (7). Pas kthimit të lëndës në rigjykim, lënda i ishte caktuar gjyqtarit [V], pasi i njëjti ishte pensionuar, lënda i ishte ngarkuar gjyqtares [X], kurse me pensionimin e kësaj të fundit, lënda kishte kaluar për shqyrtim te gjyqtari [Y], i cili ishte përjashtuar nga gjykimi i lëndës me vendim të Kryetarit të Gjykatës Themelore pas kërkesës së paditësit. Më tutje, lënda kishte kaluar te gjyqtari [Z], por se me rastin e transferimit të tij në Gjykatën Themelore në Prishtinë, lënda i ishte bartur gjyqtarit [U].

85. Gjykata rikujton edhe njëherë se më 22 shkurt 2020, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar ankesë disiplinore ndaj gjyqtares [X], për arsyet e lartcituara në këtë Aktgjykim. Ndërlidhur me këtë kërkesë, më 9 mars 2020, U.D Kryetari i Gjykatës Themelore në Pejë, pas vlerësimit të ankesës dhe shikimit të shkresave të lëndës kishte gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore për parashtrimin e kërkesës për fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtares [X]. Në kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore theksohej se gjyqtarja e rastit ka injoruar të gjitha kërkesat e parashtruesit të kërkesës për ndërmarrjen e veprimeve, edhe pse seancën për shqyrtimin e kundërshtimit ndaj Aktvendimit për caktimin e masës së përkohshme ka pasur detyrë ta caktojë sipas detyrës zyrtare. Ndër të tjera, specifikohej se *"U.D Kryetari i Gjykatës vlerëson se gjyqtarja **ka shkelur obligimin e saj ligjor për kryerjen e detyrës zyrtare me kohë**, ashtu siç është paraparë me ligj. Andaj, me këtë rast gjyqtari i çështjes e ka shkelë ligjin e procedurës kontestimore e me këtë edhe ka bërë shkelje disiplinore".*

86. Tutje, Gjykata po ashtu vëren se në këtë rast, më 8 gusht 2023, paditësi kishte kërkuar të përjashtohej nga shqyrtimi i lëndës gjyqtari [Y], dhe se kjo kërkesë e tij ishte aprovuar më 16 gusht 2023, mirëpo arsyet e përjashtimit të gjyqtarit nuk janë bërë të ditura nga ana e Gjykatës Themelore me rastin e përgjigjeve të dhëna në pyetjet e parashtruara nga Gjykata.

87. Sa i përket seancave të mbajtura dhe atyre që nuk janë mbajtur, Gjykata do t'i pasqyrojë në vijim përgjigjet e Gjykatës Themelore ndërlidhur me atë se sa seanca janë caktuar nga ana e gjyqtarëve që kishin pasur në shqyrtim çështjen, sa prej tyre janë mbajtur, dhe sa prej tyre nuk janë mbajtur, duke përfshirë edhe arsyet e mosmbajtjes të tyre.

88. Në periudhën kur lënda ishte e ngarkuar te gjyqtari [XH]: (i) seanca e 2 shtatorit 2007 është mbajtur; (ii) seanca e 12 dhjetorit 2007 është mbajtur; si dhe (iii) seanca e 23 qershorit 2008 është mbajtur. Ndërkaq, në periudhën kur lënda ishte e ngarkuar për shqyrtim te gjyqtari [ZH], nuk ishte mbajtur seanca e 2 nëntorit 2007, si pasojë e mungesës së adresës së të paditurve.

89. Ndërkaq, kur lënda ishte e ngarkuar te gjyqtari [V]: (i) seanca e 4 shtatorit 2014 është mbajtur; (ii) seanca e 12 dhjetorit 2016 nuk është mbajtur, pasi të paditurit nuk janë ftuar në mënyrë të rregullt; (iii) seanca e 7 shkurtit 2017 nuk është mbajtur, pasi është bërë zgjerimi i padisë dhe me kërkesë të palëve është shtyrë; (iv) seanca e 19 korrikut 2017 nuk është mbajtur, pasi ka pasur njoftim nga avokati i parashtruesit të kërkesës për vdekjen e të paditurit [M.V]; dhe (v) seanca e *"11 janarit 2019"* nuk është mbajtur, pasi ka pasur parashtresë për shtyrje nga përfaqësuesi i të paditurit.

90. Në vijim, rezulton se kur lënda ishte e ngarkuar për shqyrtim te gjyqtarja [X]: (i) seanca e 16 majit 2018 nuk është mbajtur dhe është shtyrë me kërkesë të përfaqësuesit të të paditurve; (ii) seanca e 12 qershorit 2018 është mbajtur; (iii) seanca e 12 korrikut 2018 nuk është mbajtur në mungesë të procesmbajtësit, sepse i njëjti ka qenë i vetmi që ka mundur të mbajë procesverbalin në gjuhën serbe; (iv) seanca e 12 shtatorit 2018 është shtyrë me kërkesë të paditësit; (v) seanca e 25 tetorit 2018 nuk është mbajtur në mungesë të dëshmisë për ftesë të rregullt të palëve në mënyrë të rregullt; (vi) seanca e 13 janarit 2019 është mbajtur; (vii) seanca e 19 gushtit 2019 është mbajtur; (viii) seanca e 25 shtatorit 2019 nuk është mbajtur në mungesë të dëshmisë për ftesë të palëve në mënyrë të rregullt dhe nuk është vendosur në Gazetën Zyrtare për përfaqësuesin e përkohshëm; (ix) seanca e 18 tetorit 2019 nuk është mbajtur në mungesë të përfaqësuesit të përkohshëm dhe të paditurit nuk kanë pranuar ftesë në mënyrë të rregullt; (x) seanca e 15 nëntorit 2019 është mbajtur; (xi) seanca e 16 dhjetorit 2019 është mbajtur; (xii) seanca e 10 shkurtit 2020 është mbajtur; dhe (xiii) seanca e 24 shkurtit 2020 nuk është mbajtur, për shkak të kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit nga përfaqësuesit e të paditurve.

91. Gjatë periudhës kohore kur lënda ishte e caktuar te gjyqtari [Y], rezulton se (i) seanca e 28 janarit 2022 nuk është mbajtur në mungesë të adresës të së paditurve, sepse të njëjtit gjenden në Serbi; (ii) seanca e 8 dhjetorit 2022 nuk është mbajtur, respektivisht është shtyrë me kërkesë të përfaqësuesit të parashtruesit të kërkesës; (iii) seanca e 18 korrikut 2023 nuk është mbajtur, pas kërkesës së përfaqësuesit të të paditurve, avokatit Teki Bokshi dhe avokatit [S.B.] për shtyrje të seancës pas mungesës së palës paditëse [N.B.]; dhe (iv) seanca e 20 shtatorit 2023 nuk është mbajtur dhe është shtyrë me kërkesën përmes parashtresës së përfaqësuesit të paditësit.

92. Gjatë periudhës kohore kur lënda u ngarkua te gjyqtari [Z], nga shkresat e lëndës rezulton se më 11 shtator 2023, Gjykata përmes një njoftimi bëri të ditur se përfaqësuesi i autorizuar i paditësit kishte kërkuar që seanca e caktuar për 29 shtator 2023 të shtyhet për një datë tjetër. Po ashtu, në njoftim theksohet se: *"Andaj,nisur nga kërkesa për shtyrje, e përshkruar si më lartë, por edhe nga arsyet objektive që ka gjykata, që çështjen që iu është caktuar së fundmi, gjyqtari i çështjes, si gjyqtar i ri i ngarkuar me lëndën, vlerëson se i nevojitet një kohë më e gjatë për të lexuar,studiuar çështjen, sepse si e tillë është mjaft voluminoze"* ,duke bërë të ditur se lidhur me seancën e radhës, gjykata me ftesa të rregullta do t'i njoftojë të gjitha palët ndërgjyqëse. Ndërsa, seanca e

caktuar për 15 nëntor 2023, nuk u mbajt në mungesë të dëshmisë për ftesë të palëve të paditura në mënyrë të rregullt.

93. Nga shkresat e lëndës të dorëzuara nga parashtruesi i kërkesës me rastin e paraqitjes së kërkesës në Gjykatë, rezulton se më 23 tetor 2020, paditësi kërkoi nga Gjykata që të ndërpresë procedurën me arsyetimin se *"Meqenëse në rastin konkret paditësi nuk gjendet në Kosovë, por punon dhe vepron jashtë territorit te Kosovës, dhe për shkak të mos mundësisë qe te vije në Kosovë, për shkak te pandemisë se Virusit Corona-19, si dhe për shkak qe mua si i autorizuar i tij, me ka humbur kontakti përkohësisht, atëherë në kuptim te kësaj dispozite propozojë qe procedure te NDËRPREHET, derisa te plotësohen kushtet për vazhdimin e sajë"*. Po ashtu, rezulton se më 11 korrik 2023, paditësi kërkoi që të shtyhet seanca e caktuar më datë 18 korrik 2023, pasi gjendet në pushim vjetor dhe nuk jetë prezent në Kosovë, duke kërkuar që të caktohet seanca në muajin shtator. Njëherësh nga shkresat e lëndës rrjedh se seanca e 15 nëntorit 2023, kur gjyqtari i rastit ishte [Z], nuk është mbajtur në mungesë të dëshmisë për ftesë të palëve të paditura në mënyrë të rregullt. Ndërkaq, nga shkresat e lëndës po ashtu, rezulton se më 11 shtator 2023, Gjykata Themelore ne Pejë përmes një njoftimi bëri të ditur se përfaqësuesi i autorizuar i paditësit kishte kërkuar që seanca e caktuar për 29 shtator 2023 të shtyhet për një datë tjetër. Po ashtu, në njoftim theksohet se *"Andaj, nisur nga kërkesa për shtyrje, e përshkruar si më lartë, por edhe nga arsyet objektive që ka gjykata, që çështjen që iu është caktuar së fundmi, gjyqtari i çështjes, si gjyqtar i ri i ngarkuar me lëndën, vlerëson se i nevojitet një kohë më e gjatë për të lexuar, studiuar çështjen, sepse si e tillë është mjaft voluminoze"*, duke bërë të ditur se lidhur me seancën e radhës, gjykata me ftesa të rregullta do t'i njoftojë të gjitha palët ndërgjyqëse.

94. Po ashtu, Gjykata rikujton përgjigjen e Gjykatës Themelore se *"Lënda nga data 14.03.2025 i është ndarë gjyqtarit të ri [U], i cili nga kjo datë deri me datë 14.09.2025 ka qenë në periudhë të mentorimit si pjesë e programit në Akademinë e Drejtësisë. Tutje, nga muaji Nëntor 2025 është gjyqtari i vetëm i cili pranon lëndë të rregullta nga lëmia civile përmes sistemit të shpërndarjes së lëndëve në mënyrë elektronike (SMIL), pasi që gjyqtari tjetër është në prag të pensionimit. Si rrjedhojë nga kjo datë e në vazhdim i njëjti është marrë me trajtimin e lëndëve të natyrave urgjente e po ashtu lidhur me objektin e njëjtë të kontestit me palët e njëjta gjyqtari [U] ka zgjidhur lëndën më objekt të kontestit të pengim posedimit dhe si rrjedhojë e kësaj kjo lëndë nuk është caktuar nga gjyqtari aktual"*.

95. Gjykata po ashtu rikujton dhe njëherë veprimet tjera procedurale të ndërmarra në këtë rast (i) më 4 shtator 2014, përfaqësuesi i të padituri [M.K.], gjatë seancës, deklaroi se me vendimin e Gjykatës Supreme është konstatuar se i padituri [S.V.] ka vdekur në vitin 1991 dhe se në këtë situatë nuk ka kushte për procedim të mëtutjeshëm derisa të përcaktohen trashëgimtarët e tij. Në po të njëjtën ditë, përmes aktvendimit procedural, procedura në këtë çështje kontestimore u ndërpre dhe u konstatua se do të vazhdojë *"pas propozimit respktivishtë pas parshtrimit të vendimit për trashëgimtret e të padituri [S.V.]"*; (ii) më 13 shtator 2016, paditësi paraqiti parashtresë mbi ndryshimin, zgjerimin dhe precizimin e kërkesëpadisë, duke bërë të ditur se tani e tutje baza e kërkesëpadisë së tij është anulimi i kontratës dhe vërtetimi i pronësisë në bazë të mbajtjes; (iii) më 22 shkurt 2020, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë disiplinore ndaj gjyqtares [X], të cilën më 9 mars 2020, U.D Kryetari i Gjykatës Themelore në Pejë, pas vlerësimit të ankesës dhe shikimit të shkresave të lëndës, e aprovoi pasi gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për parashtrimin e kërkesës për fillimin e procedurës disiplinore ndaj ish-gjyqtares [X]; (iv) më 31 korrik 2023, parashtruesi i kërkesës kërkoi nga kryetari i Gjykatës Themelore në Pejë që ta delegojë lëndën në një gjykatë tjetër. Ndërkaq, më 11 gusht 2023, Kryetari i Gjykatës Themelore në Pejë kërkoi që parashtruesi i kërkesës ta plotësojë parashtresën e sipërpërmendur, për arsyet e

elaboruara më lart në këtë Aktgjykim; si dhe (v) më 16 gusht 2023, kërkesa e 8 gushtit 2023 paditësit për përjashtim të gjyqtarit [Y] u aprovua, e që si rrjedhojë lënda u bart te gjyqtari [Z]; si dhe (v) më 1 mars 2024, procedura në këtë çështje kontestimore u ndërpre për shkak të vdekjes së të padituri [M.K.].

96. Nga ajo më sipër, rezulton se ka pasur seanca që janë shtyrë si rrjedhojë e asaj që të padituri nuk janë ftuar në mënyrë të rregullt ose për shkak të mungesës të dëshmisë për ftesë të palëve në mënyrë të rregullt, mungesës së procesmbajtësit, sepse ka qenë vetëm një (1) që ka mundur të mbajë procesverbalin në gjuhën serbe, mungesës së adresës së padituve pasi disa gjenden në Serbi, mosvendosjen e njoftimit përkitazi me përfaqësuesin e përkohshëm në Gazetën Zyrtare. Po ashtu, rezulton se ka pasur seanca që nuk janë mbajtur me kërkesë të palëve ndërgjyqëse, përfshirë këtu paditësin, por edhe përfaqësuesin e palëve të paditura -përfshirë këtu edhe parashtruesit të kërkesës. Gjatë kësaj procedure gjyqësore nga shkresat e lëndës dhe përgjigjet e Gjykatës Themelore rezulton se kanë ndërruar jetë tre (3) nga të padituri. Gjykata po ashtu vëren se rezulton se dy (2) herë procedura ishte ndërprerë si pasojë e vdekjes së dy (2) nga të padituri, ndërkaq me një rast përfaqësuesi i palës paditëse kishte kërkuar që të ndërprehet procedura deri sa të plotësohen kushtet për vazhdimin e saj, si pasojë e pamundësisë së paditësit që të paraqitet në Kosovë për shkak të pandemisë COVID-19 si dhe për shkak se si i autorizuar i paditësit i ka humbur kontakti me këtë të fundit përkohësisht.

97. Po ashtu, rezulton se gjashtë (6) gjyqtarë janë ngarkuar me lëndën dhe tani lënda është e ngarkuar te gjyqtari i shtatë (7) , ku prej tyre një (1) gjyqtar është përjashtuar nga lënda, derisa për (1) një tjetër, U.D. Kryetari i Gjykatës Themelore kishte parashtruar kërkesë për inicimin e procedurës disiplinore pasi *"U.D Kryetari i Gjykatës vlerëson se gjyqtarja **ka shkelur obligimin e saj ligjor për kryerjen e detyrës zyrtare me kohë**, ashtu siç është paraparë me ligj. Andaj, me këtë rast gjyqtari i çështjes e ka shkelë ligjin e procedurës kontestimore e me këtë edhe ka bërë shkelje disiplinore"*.

98. Nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se përkundër faktit që parashtruesi i kërkesës, paditësi dhe palët e paditura, respektivisht palët ndërgjyqëse, me veprimet e tyre kanë kontribuar në zvarritjen e procedurës, edhe Gjykata Themelore ka ndikuar në kohëzgjatjen e tepruar të procedurës në këtë rast, me veprime që i kanë kontribuar zvarritjes së lëndës, duke mos ndërmarrë masa adekuate dhe efikase për të zgjidhur çështjen brenda një afati të arsyeshëm, duke bërë që shteti të mos përmbushë detyrimin e tij për sigurimin e të drejtës efektive për gjykim brenda një afati të arsyeshëm sipas nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

(d) Rëndësia e asaj çfarë është në rrezik për parashtruesin në kontest

99. Në lidhje me parimin e rëndësisë së asaj që është në rrezik për palën në kontest, Gjykata rikujton se sipas praktikës së konsoliduar të GJEDNJ-së, disa kategori të rasteve kërkojnë vëmendje të veçantë dhe urgjencë në veprimtarinë e gjykatave të brendshme, duke pasur parasysh ndikimin e drejtpërdrejtë që mund të ketë rezultati i procedurës mbi të drejtat themelore të palës.

100. Rasti i parashtruesit të kërkesës nuk mund të thuhet se i takon një kategorie të tillë. Megjithatë, Gjykata thekson se nuk mund të konsiderohet e arsyeshme një periudhë kaq e gjatë për zgjidhjen e një rasti të tillë, pavarësisht natyrës së rastit. Gjykata konsideron se tejzgjatja e trajtimit të çështjes në fjalë është e papranueshme në rrethanat e rastit konkret dhe si e tillë është në kundërshtim të plotë me të drejtën e parashtruesit të kërkesës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm, ashtu siç garantohet nga paragrafi 2 i nenit 31 të Kushtetutës dhe paragrafi 1 i nenit 6 të KEDNJ-së.

101. Si përfundim, Gjykata, konstaton se: (ii) që nga inicimi i këtij rasti deri në paraqitjen e kërkesës në Gjykatë për vlerësim të kushtetutshmërisë së tejzgjatjes së procedurës kanë kaluar gjashtëmbëdhjetë (16) vite, dhjetë (10) muaj dhe shtatëmbëdhjetë (17) ditë ndërlidhur me çështjen juridiko-civile që ende pret të zgjidhet në merita nga Gjykata Themelore. Ndërkaq, përkitazi me kohëzgjatjen e procedurës nga përfshirja e parashtruesit të kërkesës në cilësinë e palës ndërgjyqëse në këtë kontest civil, Gjykata vëren se nga 13 shtator 2016 deri më 2 maj 2025, kanë kaluar tetë (8) vjet, shtatë (7) muaj dhe nëntëmbëdhjetë (19) ditë dhe se kjo është periudha që Gjykata mori parasysh në lidhje me pretendimet e parashtruesit të kërkesës; (ii) rrethanat e rastit konkret kanë të bëjnë me çështje pronësore, ku janë të përfshirë shumë palë në cilësinë e të paditurve, dhe se natyra e rastit është komplekse dhe mund të kërkojë shqyrtimin e shumë çështjeve faktike dhe ligjore, përfshirë këtu administrimin dhe vlerësimin e provave. Megjithatë, nuk mund të justifikohet një procedurë me kohëzgjatje të tillë; (iii) parashtruesi i kërkesës pavarësisht se ka ndërmarrë veprimeve procedurale dhe ka ushtruar të drejtën e tij për mjetet procedurale që i kishte në dispozicionin, i ka kontribuar vonesës së procedurës; ndërsa (iv) përkundër faktit që parashtruesi i kërkesës, paditësi dhe palët e paditura, respektivisht palët ndërgjyqëse, me veprimet e tyre kanë kontribuar në zvarritjen e procedurës, Gjykata vlerëson se edhe Gjykata Themelore në Pejë, Dega në Klinë ka ndikuar në kohëzgjatjen e tepruar të procedurës në këtë rast, me veprime që i kanë kontribuar zvarritjes së lëndës, dhe duke mos ndërmarrë masa adekuate dhe efikase për të zgjidhur çështjen brenda një afati të arsyeshëm, duke bërë që shteti të mos përmbushë detyrimin e tij për sigurimin e të drejtës efektive për gjykim brenda një afati të arsyeshëm sipas nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

102. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se në rrethanat e parashtruesit të kërkesës, Gjykata Themelore ka shkelur të drejtën e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm, siç garantohet me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

103. Në këtë kontekst, Gjykata thekson se, pas këtij Aktgjykimi, nëpërmjet të cilit konstatohet shkelja e nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata Themelore duhet të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm proceduralë për procedimin e mëtejmë të lëndës, me dinamikë dhe prioritet, në mënyrë që t'i japë epilog çështjes juridike të parashtruesit të kërkesës brenda një afati sa më të shpejtë kohor, konform gjetjeve të këtij Aktgjykimi. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se përfundimi i lartcekur ka të bëjë ekskluzivisht me kohëzgjatjen e procedurave sa i përket shqyrtimit të rastit të parashtruesit të kërkesës dhe në asnjë mënyrë nuk paragjykon rezultatin e meritave të rastit të tij para gjykatave të rregullta.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, në nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullin 48 (1) (a) të Rregullores së punës, në seancën e saj të mbajtur më 30 shtator 2026, njëzëri:

VENDOS

I. TA SHPALLË kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të paragrafit 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përkitazi me të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm kohor;

III. TA URDHËROJË Gjykatën Themelore në Pejë, Dega në Klinë, që jo më larg se 16 maj 2027 ta informojë Gjykatën Kushtetuese lidhur me masat e ndërmarra për zbatimin e këtij Aktgjykimi, në pajtim me paragrafin 5 të rregullit 60 (Zbatimi i vendimeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese;

IV. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve dhe, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës;

V. TË KONSTATOJË se ky Aktgjykim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Bajram Ljatifi Nexhmi Rexhepi